



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania,

Tel/Fax 04 22268141 ; 22268142

Nr 3446 Prot.

Tiranë, më 21.05.2015

V E N D I M

Nr. 48 date 21.05.2015

**Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të deklarimit të statusit të punësimit
nëpunësit *******

Me urdhërin nr. 344/1 prot. dt. 11.05.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar procesi i verifikimit të rastit të punonjësit të Autoritetit të Aviacionit Civil, i cili pretendon se për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitës së nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", nga ana e njësisë të burimeve njerëzore dhe njësisë përgjegjëse, nuk ka përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil.

Ndërkaq, pas fillimit të procesit të verifikimit, me shkresën nr. 1979/1 dt. 13.05.2015 të Drejtores së Departamentit të Administratës Publike, jemi vënë në dijeni se nga ana e këtij të fundit, ka filluar inspektimi dhe rivlerësimi i praktikave të deklarimit të statusit të punësimit, për gjithë nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil, proces i cili është në vazhdim.

Në këto kushte, kur vetë njësia përgjegjëse, është duke rivlerësuar procesin e deklarimit të statusit për punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil, konstatoj se duhet të pezullohet procesi i verifikimit të informacionit të ***** , nga ana e Inspektorëve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, deri në përfundim të rivlerësimit të kësaj praktike, nga ana e njësisë përgjegjëse.

Për këto arsye

Duke u bazuar në nenin 78 të ligjit nr. 8485 dt. 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”

V E N D O S A

Pezullimin e procesit të verifikimit të deklaramit të statusit të nëpunësit të Autoritetit të Aviacionit Civil, ***** , deri në përfundim të rivlerësimit të akteve të deklaramit/refuzimit të statusit të punësimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA